

# Vaksinimet në fëmijëri dhe në adoleshencë

**INFORMOHEM,  
TË VAKSINOJ,  
TË MBROJ.**

# Treguesi i lëndës

<b>2</b>	Përfitimet	<b>22</b>	Parotite
<b>5</b>	Vaksinat e kombinuara	<b>24</b>	Rozolia
<b>6</b>	Poliomieliti	<b>26</b>	Varicela
<b>8</b>	Difteria	<b>29</b>	Pneumokoku
<b>10</b>	Tetanos	<b>32</b>	Meningokoku
<b>12</b>	Hepatiti B	<b>34</b>	Hepatiti A
<b>14</b>	Kolla e mirë	<b>36</b>	Rotavirus
<b>17</b>	Hemofilia (HIB)	<b>38</b>	Gripi
<b>19</b>	Fruthi	<b>42</b>	HPV

**INFORMOHEM,  
TË VAKSINOJ,  
TË MBROJ.**

# Përfitimet

**Vaksinimet kanë ndihmuar në zhdukjen e sëmundjeve serioze infektive**, siç është lia, ose për të zvogëluar në mënyrë drastike përhapjen e tyre, si në rastin e poliomielitit, tetanosit dhe difterisë. **Vetëm kur një sëmundje është zhdukur nga i gjithë planeti është e mundur të pezullohen vaksinimet**; përkundrazi kur sëmundja, edhe nëse është më pak e shpeshtë, manifestohet përsëri, **do të ishte jashtëzakonisht e rrezikshme të ndalojmë vaksinimin, sepse sëmundja mund të rishfaqet dhe të përhapet në të gjithë popullsinë**. Principi mbi të cilin bazohet vaksinimi është që të stimulojë prodhimin nga ana e organizmit, duke simuluar përgjigjen natyrale të sistemit tonë imunitar, të mbrojtjeve specifike kundër viruseve dhe baktereve, duke përdorur pjesë shumë të vogla të viruseve ose të toksinave të tyre të bëra të padëmshme, ose duke përdorur vetë viruset, të shndërruar në viruse shumë të dobët dhe për këtë arsye jo të rrezikshëm. Në këtë mënyrë, individit i vaksinuar që bie në kontakt me mikrobet e vërteta, të gjalla dhe të rrezikshme, tashmë është në gjendje të mbrohet dhe nuk e shfaq sëmundjen, ose e manifeston atë në një formë të lehtë.

**Në përgjithësi vaksinat tolerohen mirë dhe nuk shkaktojnë shqetësime**. Reagimet serioze janë absolutisht të jashtëzakonshme dhe shumë më pak të shpeshta sesa komplikimet e shkaktuara nga sëmundjet.

Vaksinat janë gjithashtu të dobishme për komunitetin, sepse në shumicën e rasteve personat e vaksinuar as nuk sëmuren e as mund të transmetojnë sëmundje. Të pa vaksinuarit, nga ana tjetër, mund të transmetojnë sëmundje në fazën e inkubacionit, ose si mbartës të shëndetshëm. Duke vaksinuar një përqindje të lartë të individëve, mbrohen indirekt edhe të **porsalindurit, shumë të vegjël për t'u vaksinuar dhe për të cilët sëmundjet janë veçanërisht të rrezikshme**, subjektet e prekur nga sëmundjet për të cilët vaksinimet

janë joefikase ose të rrezikshme dhe gratë shtatzëna, të cilat mund të marrin vetëm disa vaksina.

**Ky mekanizëm, i quajtur imuniteti i tufës, çon në një ulje shumë të fortë të rasteve ose madje edhe në zhdukjen e sëmundjes.**

## PËRPARA VAKSINIMIT

- NË TË GJITHË AMBULATORËT RAJONAL TË VAKSINIMIT, OPERATORËT E SPECIALIZUAR JANË NË DISPOZICION PËR TË DHËNË TË GJITHA INFORMACIONET MBI KËTË TEMË.
- PËRPARA VAKSINIMIT, DO TË VLERËSOHET NËSE KA ARSYE PËR TA SHTYRË SOMINISTRIMIN E VAKSINËS: ËSHTË GJË E RRALLË QË TË KETË KUNDËRINDIKACIONE PËR VAKSINIMET, POR SIDOQOFTË TAKIMI ME PERSONELIN SANITAR DO TË MUNDËSOJË QË TË PËRCAKTOHET NËSE EKZISTOJNË SHQETËSIME OSE KUSHTE TË TILLA PËR TË SHKËSHILLUAR OSE VONUAR VAKSINIMIN.
- PËR PRINDËRIT DO TË VIHEN NË DISPOZICION SKEDAT INFORMATIVE PËR VAKSINAT E PRANISHME NË AMBULATOR DHE, SI PËR ÇDO PRAKTIKË MJEKËSORE, DO T'U KËRKOHET TË NËNSHKRUAJNË MIRATIMIN.
- GJITHASHTU DO T'U SQAROHET ATYRE SE SI DUHET TË PËRBALLOJNË SHQETËSIMET E VOGLA TË MUNDSHME QË MUND TË SHFAQEN PAS VAKSINIMIT.
- NË VARËSI TË VAKSINËS, PËR SOMINISTRIM MUND TË LYPSËN NJË OSE MË SHUMË DOZA.
- NUK ËSHTË E NEVOJSHME QË FËMIJËT TË PARAQITEN PANGRËNË.

**PËRFITIMET E PRODHUARA  
NGA VAKSINAT,  
SI PËR INDIVIDIN ASHTU  
EDHE PËR KOMUNITETIN,  
JANË SHUMË MË TË MËDHA  
SE RREZIQET.**

## PAS VAKSINIMIT

**Ngjarje të rënda që kanë lidhje me vaksinimin janë jashtëzakonisht të rralla, por jo të pamundura.** Menjëherë pas soministrimit, prindërit dhe fëmijët ftohen të qëndrojnë në sallën e pritjes për 30 minuta për të vëzhguar reaksionet e mundshme të dëmshme. Në raste shumë të rralla, në fakt, menjëherë pas vaksinimit mund të vërtetohen reaksione alergjike, madje serioze (shok anafilaktik), ashtu si dhe pas soministrimit të çdo ilaçi tjetër. **Të gjithë ambulatorët e vaksinimit në rajonin tonë janë të pajisur për të përballuar më mirë këto lloj situatash.** Është e rëndësishme të dimë se cilat janë efektet anësore më të zakonshme në mënyrë që të mos alarmoheni.

Reaksioni më i shpeshtë që zakonisht shfaqet brenda 24-48 orëve nga soministrimi i vaksinës janë etheet, që mund të shoqërohen me nervozizëm dhe humbje të oreksit; shumë më pak të shpeshta janë të vjellat dhe diarreja. Në raste të rralla, rritja e temperaturës mund të shkaktojë një krizë konvulsionesh (konvulsion febril) që nuk duhet ngatërruar me epilepsinë. Përve kësaj mund të vërehen edhe reaksione lokale të tilla si ënjtje, skuqje, indurim dhe dhimbje në vendin ku është soministruar vakcina, të cilat zakonisht zhduken brenda disa orësh ose ditësh. Takimi me personelin sanitar përpara vaksinimit do të zgjidhë çdo dyshim që mund të keni.

Nëse fëmija juaj mund të paraqesë simptoma që ju shqetësojnë gjatë orëve ose ditëve menjëherë pas vaksinimit, mund të drejtoheni te pediatri juaj i besuar, te mjeku që ka bërë vaksinimin ose te ndihma e shpejtë pediatrike për çdo kurë të mundshme.

Çdo reaksion i mundshëm i kundërt ndaj vaksinës sinjalizohet dhe vlerësohet nga organet kompetente, sipas parimit të parandalimit: edhe ngjarjet që nuk lidhen domosdoshmërisht me vaksinimin, sidoqoftë, regjistrohen dhe analizohen.

Vaksinimet në fëmijëri dhe në adoleshencë | 4

## Vaksinat e kombinuara

Me vakcina të kombinuara (ose të shoqëruara) nënkuptojmë formulime që përmbajnë shumë vakcina (d.m.th. me më shumë antigjene) në të njëjtën ampulë, pra një ilaç i vetëm që mbron nga disa sëmundje, nuk ka më disa ilaçe që soministrohen njëkohësisht.

### VAKSINAT E KOMBINUARA TË PËRDORURA NORMALISHT JANË:

- **HEKZVALENTE** (poliomieliti, difteria, tetanosi, hepatiti B, kolla e mirë, hemofili B), soministrohet në tre doza gjatë vitit të parë të jetës.
- **TRIVALENTE MPR** (fruthi, shytat, rozolia), soministrohet në moshën 12-15 muajsh dhe 5-6 vjeç.
- **TETRAVALENTE MPRV** (fruthi, shytat, rozolia, varicella), soministrohet në moshën 12-15 muajsh dhe 5-6 vjeç.
- **TETRAVALENTE IPV-DTPa OSE IPV-dTpa\*** (poliomieliti, difteria, tetanosi, kolla e mirë), e cila është përdorur për përsëritje në moshën 5-6 vjeç dhe te adoleshentët.
- **TRIVALENTE dTpa** (difteri, tetanos, kollë e mirë) përdoret për përsëritjen e vaksinës tek adoleshentët/rriturit.
- Ekzistojnë edhe kombinime të tjera që përdoren herë pas here.

**Vaksinat e kombinuara janë të dobishme për fëmijët sepse një soministrim i vetëm i mbron ata njëkohësisht nga shumë sëmundje pa e bërë vaksinën më "të rëndë".** Vaksinimet dhe/ose përsëritja e vaksinave që janë bërë në moshën e fëmijërisë këshillohen gjithashtu edhe për adoleshentët dhe të rriturit, veçanërisht për gratë në moshën e riprodhimit dhe në subjektet që janë të prekur nga patologji të caktuara. Edhe për gruan shtatzënë, rekomandohen disa vaksinime për ta mbrojtur atë dhe për të mbrojtur fëmijën që do të lindë. Vakcina zakonisht soministrohet me një injeksion të vogël në pjesën e përparme anësore (anterolaterale) të kofshës te foshnjat dhe në pjesën e sipërme të krahut në moshat më të mëdha. Ata që kanë pasur një ose më shumë sëmundje ndaj të cilave mbron vakcina e kombinuar mund të vaksinohen njësoj, pa pasur ndonjë rrezik për patologjitë e mbetura.

\* DTPa: formulim pediatrik. // dTpa: formulim adoleshent/i rritur.

# Poliomieliti

Poliomieliti është një sëmundje infektive e shkaktuar nga 3 lloje të ndryshme virusesh që hyjnë në trup kryesisht nëpërmjet aparatit të tretjes. **Bëhet fjalë për një sëmundje shumë të rrezikshme që në rastet më të rënda mund të shkaktojë paralizë, kryesisht të gjymtyrëve, dhe ndonjëherë edhe vdekjen.** Nuk ekzistojnë ilaçe që mund të kurojnë poliomielitin; mundësia e vetme reale për të shmangur efektet e saj të tmerrshme qëndron në parandalimin e sëmundjes.

Përmirësimi i kushteve higjienike ka kontribuar për të reduktuar përhapjen e shumë sëmundjeve infektive, por kjo nuk është vërtetuar në rastin e poliomielitit, përhapja e të cilit ka qenë madje lehtësuar. Në fakt, përmirësimi i kushteve higjienike-sanitare ka çuar në një vonesë të moshës në të cilën fëmijët ndeshnin për herë të parë virusin, kështu që në kohën e ekspozimit ata nuk ishin të mbrojtur më nga antitruapat e nënës. **Vetëm nëpërmjet vaksinimit jemi të sigurt për mbrojtjen e fëmijëve dhe mund të shmangim epidemitë.**

Në vitin 1958, para se të bëhej vaksinimi, në Itali u verifikuan epidemi të ndryshme poliomieliti, me 8,000 raste paralizash; nga viti 1966 vaksinimi u bë i detyrueshëm. Rezultati ka qenë jashtëzakonisht pozitiv: në Itali 2 rastet e fundit të poliomielitit u regjistruan në vitin 1982 në fëmijë të pa vaksinuar, dhe në vitin 2002 Organizata Botërore e Shëndetit (OBSH) e ka shpallur Evropën të lirë nga polivirusi. Sidoqoftë, me të gjitha përpjekjet dhe angazhimin, poliomieliti nuk është zhdukur akoma nga planeti: në fakt, ai është akoma i pranishëm në disa vende të Afrikës dhe Azisë.

## VAKSINA

QË NGA VITI 2002, NË ITALI, VAKSINIMI NDAJ POLIOMIELITIT PARASHIKOHET NË SOMINISTRIMIN E 4 DOZAVE TË VAKSINAVE, TË QUAJTURA IPV (OSE SALK), QË PËRMBAJNË VIRUSE TË POLIOMIELITIT TË ÇAKTIVIZUAR, D.M.TH. TË MBYTUR. **3 DOZAT E PARA SOMINISTROHEN NË VITIN E PARË TË JETËS, PËRGJITHËSISHT ME NJË INJEKSION TË VETËM SË BASHKU ME VAKSINAT E TJERA NË TË ASHTUQUAJTURIN HEKZVALENT.** DOZA E KATËRT SOMINISTROHET NDËRMJET 5 DHE 6 VJEÇ, ZAKONISHT ME TETRAVALENTEN IPV-dTpa, E CILA SHËRBEN SI VAKSINË E PËRSËRITUR (SHIH "VAKSINAT E KOMBINUARA", FAQE 5). NGA VITI 2018 PLANI I RI KOMBËTAR I PARANDALIMIT ME VAKSINIME PARASHIKON NJË DOZË TË PESTË TË VAKSINËS TEK ADOLESHENTËT, TË SOMINISTRUAR ME TETRAVALENTEN IPV-dTpa.

**EFIKASITETI I VAKSINIMIT ËSHTË SHUMË I LARTË: POTHUAJSE TË GJITHË PERSONAT E VAKSINUAR REAGONJË POZITIVISHT DHE E MBAJNË MBROJTJEN PËR NJË KOHË TË GJATË. VAKSINA ORALE E GJALLË E ZBUTUR (OSE SABIN) NUK PËRDORET MË NË ITALI QË NGA VITI 2002.**

## EFEKTET ANËSORE

**Vaksina IPV ka një shkallë shumë të lartë sigurie. Shumica e fëmijëve nuk ka pasur ndonjë shqetësim pas soministrimit.** Janë të rralla reagime të tilla si dhimbje ose ënjtje, në vendin ku është inokuluar vaksina, apo ethe ose dobësi. Reagimet alergjike ndaj komponentëve të vaksinës janë të jashtëzakonshme ashtu si për të gjitha vaksinat. Efiqasiteti i vaksinës për poliomielitin është shumë i lartë, ashtu si edhe shkalla e sigurisë!

**NUK KA KURA PËR POLIOMIELITIN,  
E VETMJA MËNYRË PËR TA SHMANGUR  
ATË ËSHTË PARANDALIMI!**

# Difteria

**Difteria është një sëmundje infektive shumë e rëndë që transmetohet kryesisht me rrugë ajrore nëpërmjet ajrit që nxjerrim duke folur, duke teshtirë ose gjatë kollitjes.** Shkaktohet nga një toksinë e prodhuar nga bakteri *Corynebacterium diphtheriae*, që shkakton lezione të rënda në shumë organe, siç janë zemra dhe nervat, dhe shkakton formimin e membranave të veçanta në hundë, fyt dhe laring që mund të çojnë në marrje të frymës. **Rreth 1-2 raste në 10 mund të jenë vdekjeprurëse, edhe nëse kurohen me antibiotikë.** Në Itali, në fillim të viteve 1900, regjistroheshin çdo vit në popullsinë e fëmijëve 20-30,000 raste të difterisë, me rreth 1.500 vdekje në vit. Pas përhapjes së gjerë të vaksinimit, që është bërë i detyrueshëm në Itali në vitin 1939, ka pasur një zvogëlim drastik të vdekjeve.

Në vendet e ish-Bashkimit Sovjetik rënia e vaksinimeve, për shkak të krizës së rëndë politike dhe ekonomike, ka shkaktuar në fillim të viteve '90 një epidemi të madhe e cila ka zgjatur disa vite dhe ka shkaktuar mijëra të vdekur. Ndërmjet viteve 1990 dhe 1998 janë sinjalizuar 3 raste të difterisë në Itali, të gjithë në persona të pa vaksinuar. Rastet e vdekjeve të fëmijët e pa vaksinuar në Angli, Spanjë dhe Belgjikë kohët e fundit kanë demonstruar se bakteri vazhdon të qarkullojë në Evropë dhe se ne nuk mund t'i lejojmë vetes që të mos jemi të vëmendshëm. Me gjithë sukseset e arritura në kontrollin e difterisë, zhvendosjet e shpeshta të personave ndërmjet Vendeve të ndryshme paraqesin një faktor rreziku për përhapjen e sëmundjes.

## VAKSINA

VAKSINA KUNDËR DIFTERISË PËRGATITET DUKE U NISUR NGA TOKSINA DIFTERIKE, E MODIFIKUAR NË MËNYRË TË ATILLË QË TË MOS JETË MË E RREZIKSHME (ANATOKSINA), POR PO AQ E AFTË SA PËR TË STIMULUAR ORGANIZMIN PËR TË PRODHUAR MBROJTJE TË VLEFSHME KUNDËR SËMUNDJES. **VAKSINA E DIFTERISË SOMINISTROHET SË BASHKU ME VAKSINAT E TJERA NË KOMBINIME TË NDRYSHME. KALENDARI NË FUQI I VAKSINIMIT PARASHIKON SOMINISTRIMIN E 3 DOZAVE NË MUAJIN E 3-TË, 5-TË DHE NË MOSHËN 11-VJEÇ, ME VAKSINËN HEKZVALENTE.** NJË DOZË PËRFORCUESE KRYHET NË MOSHËN 5-6 VJEÇ DHE NJË TJETËR NË 13-14 VJEÇ, GJITHMONË NË VAKSINA TË KOMBINUARA (SHIH "VAKSINAT E KOMBINUARA", FAQJA 5) DHE KËSHILLOHEN PËRSËRITJE PERIODIKE GJITHASHTU EDHE PËR TË RRITURIT, ÇDO 10 VJET, SË BASHKU ME TETANOSIN DHE KOLLËN E MIRË.

**EFIKASITETI I VAKSINIMIT KUNDËR DIFTERISË ËSHTË SHUMË I LARTË: GATI 90% E PERSONAVE TË VAKSINUAR REZULTOJNË TË MBROJTUR NGA SËMUNDJA.**

## EFEKTET ANËSORE

**Vaksina tolerohet shumë mirë dhe shumica e efekteve anësore janë të lehta.** Ngjarja më e shpeshtë është ethja, e cila shfaqet në rreth 1/3 e fëmijëve të vaksinuar. Në vendin ku është soministruar vaksina, mund të ketë një reaksion lokal kalimtar që shfaqet me ënjtje, skuqje dhe dhimbje. Këto efekte verifikohen zakonisht brenda 48 orëve nga vaksinimi. Reagimet lokale rriten me numrin e dozave të kryera: rreth 40% e fëmijëve kanë ënjtje dhe dhimbje në krah me dozën e katërt të vaksinës, të bërë në moshën 5-6 vjeç.

**DIFTERIA QARKULLON ENDE NË EVROPË,  
DHE MUND TË JETË VDEKJEPRURËSE.**

# Tetanos

Tetanos është një sëmundje infektive shumë e rëndë që shkaktohet nga një toksinë që prodhohet nga bakteri Clostridium tetani. Sëmundja është e rëndë dhe e nënvlerësuar, sepse sporet e këtij bakteri mund të mbijetojnë në ambientin e jashtëm edhe për disa vite me radhë duke kontaminuar pluhurin dhe tokën, dhe mund të hyjnë në organizmin e njeriut nëpërmjet një plage të parëndësishme ose që nuk shihet si p.sh. pickimi i një gjembi të trëndafil. Pasi të kenë depërtuar, sporet mund të shndërrohen në forma vegjetative që prodhojnë toksinën. Bakteri nuk i pushton indet por toksina e tetanosit arrin sistemin nervor qendror nëpërmjet gjakut dhe limfës, duke shkaktuar kontraktime dhe spazma difuze. Tetanos shpesh kërkon shtrime të gjata në spital, kryesisht në repartet e rianimacionit, dhe në rreth 4 raste në 10 mund të shkaktojë vdekjen.

**Edhe pse nuk është ngjitëse, sëmundja është tepër vdekjeprurëse, prandaj që nga viti 1968 në Itali është i detyrueshëm vaksinimi universal i fëmijëve të porsalindur.**

**Çdo vit sëmuren në Itali rreth 60 persona; bëhet fjalë, në pjesën më të madhe për subjekte jo të vaksinuar ose me vaksinim jo të plotë,** veçanërisht gra mbi 65 vjeç, pasi vetëm nga viti 1968 vaksinimi kundër tetanosit në Itali është bërë i detyrueshëm për të gjithë foshnjat e reja që kanë lindur. Deri atëherë ishte i detyrueshëm vetëm për ushtarakët dhe disa kategori profesionale me rrezik, për shembull punëtorët e bujqësisë, kryesisht burrat. Pikërisht vetëm pas futjes së vaksinimit, janë zvogëluar rastet e tetanosit neonatal, një formë e veçantë e tetanosit që prek të lindurit nga nënat e pa vaksinuara, të cilët nuk kanë mbrojtjen e dhënë nga antitruapat e nënës në muajt e parë të jetës, që vërehet pothuajse ekskluzivisht në vendet në zhvillim.

## VAKSINA

ASHTU SI NË RASTIN E DIFTERISË, EDHE VAKSINA E TETANOSIT ËSHTË E PËRBËRË NGA ANATOKSINA, D.M.TH TOKSINA E TETANOSIT E TRAJTUAR NË MËNYRË QË TË HUMBASË TOKSICITETIN E SAJ, MEGJITHATË DUKE RUAJTUR AFTËSINË PËR TË STIMULUAR PRODHIMIN E ANTITRUPAVE MBROJTËS. **KALENDARI NË FUQI I VAKSINIMIT PARASHIKON SOMINISTRIMIN E 3 DOZAVE NË MUAJIN E 3-TË, 5-TË DHE NË MOSHËN 11-VJEÇ, ME VAKSINËN E KOMBINUAR HEKZVALENTE. NJË DOZË PËRSËRITËSE (PËRFORCUESE) KRYHET NË MOSHËN 5-6 VJEÇ DHE NJË TJETËR NË MOSHËN 13-14 VJEÇ, GJITHMONË ME VAKSINA TË KOMBINUARA** (SHIH "VAKSINAT E KOMBINUARA", FAQE 5).

**EFIKASITETI I VAKSINIMIT KUNDËR DIFTERISË ËSHTË SHUMË I LARTË: GATI 100% E TË VAKSINUARVE REZULTON I MBROJTUR NGA SËMUNDJA. PËR KËTË ARSYE REKOMANDOHEN PËRSËRITJET E KËSAJ VAKSINE ÇDO 10 VJET.**

## EFEKTET ANËSORE

**Vaksina tolerohet mirë dhe shumica e reaksioneve janë të lehta.** Ngjarja më e shpeshtë është ethja, e cila shfaqet në rreth 1/3 e fëmijëve të vaksinuar. Në krah, në vendin ku është soministruar vaksina, mund të ketë një reaksion lokal kalimtar që shfaqet me ënjtje, skuqje dhe dhimbje. Këto efekte verifikohen zakonisht brenda 48 orëve nga vaksinimi. Reagimet lokale rriten me numrin e dozave të kryera: rreth 40% e fëmijëve kanë ënjtje dhe dhimbje në krah me dozën e katërt të vaksinës, të bërë në moshën 5-6 vjeç.

**TETANOSI  
NUK ËSHTË NGJITËS,  
POR ËSHTË TEPËR  
VDEKJEPRURËS!**

# Hepatiti B

**Hepatiti B është një sëmundje infektive virale që godet mëlçinë.** 85-90% e infeksioneve nga virusi B zhduket në mënyrë spontane dhe krejtësisht sepse organizmi arrin të mbrohet në mënyrë efikase. **Sidoqoftë, një pjesë e personave të infektuar shfaq simptoma të tilla si dobësi, neveri, të vjella, ethe, verdhëz (ngjyrë e verdhemë e lëkurës dhe syve) ose që evoluojnë në një infektion të vazhdueshëm që mund të çojë në cirozë hepatike dhe në tumor të mëlçisë.** Pasi të jemi infektuar, është e mundur të bëhemi mbartës kronikë të virusit edhe pa simptoma. Karakteristikat e përparimit të sëmundjes varen nga mosha në të cilën kontraktohet infeksioni: në moshë madhore konstatohet rreth 10% e kronicizimit (karakterit kronik), në moshën neonatale 90% të rasteve do të zhvillojnë një formë kronike, dhe te fëmijët ndërmjet 1 dhe 4 vjeç kjo do të verifikohet në 50% të rasteve. 25% e atyre që kanë kontraktuar virusin në moshën e fëmijërisë do të vdesin nga komplikime të tilla si cirroza, insuficienca hepatike e tumori i mëlçisë.

**Virusi i hepatitit B transmetohet nëpërmjet gjakut dhe lëngjeve biologjike (qumështi i gjirit, sperma, sekrecionet vagjinale) të subjekteve të infektuar, të cilët janë të sëmurë ose mbartës kronikë.** Virus gjithashtu mund të depërtojë në organizëm edhe nëpërmjet lezioneve shumë të vogla të lëkurës ose të mukozave nëpërmjet përdorimit të objekteve të kontaminuara siç janë furçat e dhëmbëve, gërsërët e brisqet. Është vërtetuar se njerëzit që jetojnë me një person të sëmurë ose me një mbartës të sëmundjes kanë rrezikun e infektimit. Fëmijët e lindur nga një nënë mbartëse kronike kanë një probabilitet të lartë për t'u infektuar, për këtë arsye atyre u jepet doza e parë e vaksinës në spital në ditën e lindjes. Vaksinimi, i bërë i detyrueshëm në Itali që nga viti 1991, ka çuar në një rënie të fortë të rasteve të hepatitit B sidomos te personat nga 15 deri në 24 vjeç dhe pritet një zvogëlim në rastet e ardhshme të tumoreve të mëlçisë.

Vaksinimet në fëmijëri dhe në adoleshencë | 12

## VAKSINA

VAKSINA KUNDËR HEPATITIT B PËRMBAN VETËM NJË PJESË TË VIRUSIT, ATË TË JASHTËM, I PAAFTË PËR TË TRANSMETUAR SËMUNDJEN, POR I MJAFTUESHËM PËR TË STIMULUAR ORGANIZMIN QË TË PRODHOJË MBROJTJE TË VLEFSHME.

**ËSHTË SHUMË EFIKAS, VEÇANËRISHT TE FËMIJËT, TË CILËT REZULTOJNË POTHUAJSE PLOTËSISHT TË MBROJTUR (DERI NË 98%).** VAKSINA NË PËRGJITHËSI SOMINISTROHET NË VAKSINËN E KOMBINUAR HEKZAVALENTE (SHIH FAQEN 5).

**VAKSINA PËR HEPATITIN B ËSHTË TEPËR EFIKASE, VEÇANËRISHT TEK FËMIJËT.**

## EFEKTET ANËSORE

**Vaksina tolerohet mirë.** Në vendin ku është soministruar mund të ketë dhimbje, skuaje dhe ënjtje, zakonisht të lehta që zhduken brenda pak ditësh.

Rrallë, mund të verifikohen: ethe me temperaturë jo të lartë, dhimbje koke, neveri, marramendje, dhimbje të muskujve dhe të kyçeve me intensitet mesatar dhe për një kohë të shkurtër. Edhe më rrallë janë sinjalizuar në fëmijët dhe të rriturit, neurite periferike që shfaqen me shqetësime të ndjeshmërisë dhe të lëvizjes.

**NËSE KONTRAKTOHET NGA NJË I PORSALINDUR, HEPATITI B BËHET KRONIK NË SHUMICËN E RASTEVE, DUKE ÇUAR NË SËMUNDJE SHPESH VDEKJEPRURËSE.**



## Kolla e mirë

Kolla e mirë është një sëmundje infektive shumë ngjitëse që shkaktohet nga bakteri *Bordetella pertussis*, **i cili transmetohet me rrugë ajrore nëpërmjet pikave të pështymës që lëshohen nga kollitja, teshtitjet ose thjesht duke folur.** Kolla e mirë manifestohet fillimisht me kollë të lehtë, sekrecione nga hunda dhe nganjëherë, ethe për 1-2 javë. Më pas, kollitja theksohet dhe manifestohet me "breshëri" të vërteta kollitjesh, që nganjëherë pasohen nga të vjella; kjo fazë zgjat rreth 4 javë. Vazhdon një periudhë pushimi, në të cilën sulmet e kollitjes gradualisht bëhen më pak intensive dhe të shpeshta. Në përgjithësi kolla e mirë shërohet pa pasoja. Sidoqoftë, është e mundur që ajo të ndërlikohet me otit, laringjit, pneumoni, konvulsione dhe dëmtim të trurit. Sëmundja mund të jetë veçanërisht e rëndë në vitin e 1-rë të jetës: te të porsalindurit dhe foshnjat, shpesh manifestohet me kriza të vërteta të apnesë (mungesë frymëmarrje), të cilat e bëjnë të detyrueshëm shtrimin në spital. Në këtë moshë, kolla e mirë mund të komplikohet me shqetësime cerebrale ose të frymëmarrjes, të cilat mund të shkaktojnë dëme të përhershme, deri në vdekje. **Kolla e mirë është veçanërisht e rrezikshme në vitin e parë të jetës.**

**Ndryshe nga sëmundjet e tjera infektive, imuniteti i dhënë nga kolla e mirë nuk është i përhershëm, por zvogëlohet me kalimin e kohës,** dhe në moshë të rritur mund të shfaqet një kollë e mirë e dytë. Në të rriturit sëmundja është më e lehtë, por zgjat për shumë kohë. Këto forma "të zbutura" shpesh nuk njihen dhe mund të infektojnë me lehtësi fëmijët më të vegjël: shpesh burimi i infeksionit është nëna. Pas përhapjes së vaksinimit, numri i rasteve ka rënë ndjeshëm në të gjithë Italinë.

## VAKSINA

KA DISA VITE QË PËRDORET E ASHTUGUAJTURA VAKSINË ACELULARE (PA STRUKTURË QELIZORE), E PËRBËRË VETËM NGA DISA "PJESË" TË VOGLA TË BAKTERIT, TEPËR TË PURIFIKUARA, DHE SHUMË MË PAK REAKTOGJENE NË KRAHASIM ME VAKSINËN E VJETËR.

**AKTUALISHT NUK ËSHTË E DISPONUESHME NJË VAKSINË E VETME E KOLLËS SË MIRË, KËSHTU QË SOMINISTROHET SË BASHKU ME VAKSINAT E TJERA NË KOMBINIME TË NDRYSHME (SHIH FAQEN 5).**

**VAKSINIMI KUNDËR KOLLËS SË MIRË REKOMANDOHET FUGIMISHT DUKE FILLUAR NGA MOSHA 2 MUAJSH,** NË MËNYRË QË TË SIGUROHET MBROJTJA E FËMIJËS NË PERIUDHËN NË TË CILËN SËMUNDJA MUND TË JETË MË E RREZIKSHME; MEGJITHATË, MUAJT E PARË TË JETËS MBETEN TË RREZIKUAR, KJO ËSHTË ARSYEJA PSE ËSHTË E **RËNDËSISHME TË SIGUROHET IMUNITETI I GRUPEVE TË POPULLSISË NËPËRMJET VAKSINIMIT** ME MBULIM TË LARTË NË TË GJITHA GRUPMOSHAT (SHIKO "PËRFITIMET", FAQE 2).

PËR TË MBROJTUR FËMIJËT MË TË VEGJËL QË AKOMA NUK JANË VAKSINUAR OSE JANË DUKE U VAKSINUAR, PËRVEÇ KËSAJ, **REKOMANDOHET TË VAKSINOHEN GRATË SHTATZËNA;** PERIUDHA IDEALE ËSHTË NDËRMJET JAVËS SË 27-TË DHE TË 32-TË TË SHTATZËNISË, NË MËNYRË QË TË SIGUROHET TRANSFERIMI MAKSIMAL I ANTITRUPAVE TË NËNËS NËPËRMJET PLACENTËS.

MBROJTJET E TRANSMETUARA NGA NËNA, E VAKSINUAR QYSH NË FËMIJËRI OSE QË KA PASUR NË TË KALUARËN KOLLËN E MIRË, NË FAKT NUK JANË TË MJAFTUESHME PËR TË MBROJTUR TË PORSALINDURIN. **RRETH 85% E INDIVIDËVE TË VAKSINUAR REZULTOJNË TË MBROJTUR MIRË NGA SËMUNDJA, VEÇANËRISHT NË SHPREHJEN E SAJ MË TË RËNDË.**

PAS 3 DOZAVE TË PARASHIKUARA NË 12 MUAJT E PARË TË JETËS, MBROJTJA ZGJAT TË PAKTËN DERI NË 5 VJEÇ.

**VAKSINAT E PËRHAPURA  
DHE TË RREGULLTA LEJOJË  
QË TË MBROHEN TË  
PORSALINDURIT.**

## Kolla e mirë

AKTUALISHT REKOMANDOHEN PËRSËRITJE TË VAKSINIT NË MOSHËN 5-6 VJEÇ DHE 13-14 VJEÇ, SI DHE PËRSËRITJE 10-VJEÇARE NË TË RRITURIT (SË BASHKU ME TETANOSIN DHE DIFTERINË), ME QËLLIM QË TË KUFIZOHET NË MAKSIMUM GARKULLIMI I MIKROBIT TË KOLLËS SË MIRË NË AMBIENT DHE PËR TË MBROJTUR TË PORSALINDURIT.

### EFEKTET ANËSORE

**Bëhet fjalë zakonisht për reaksione të lehta dhe për një kohë të shkurtër.** Në pikën e soministrit, ka mundësi të shfaqen, brenda 24/48 orëve, dhimbje, skuqje dhe ënjtje. Reagimet lokale rriten me numrin e dozave të kryera. Rreth 40% e fëmijëve kanë ënjtje ose mpirje në krah në dozën e katërt të tri/tetravalentit të soministruar në moshën 5-6 vjeç. Në 2 ditët e para, pas vaksinës, ka mundësi të shfaqen ethe, nervozizëm ose përgjumje. Rrallë herë mund të verifikohen reaksione më alarmante siç janë episodet e ngjashme me kolapsin, të qara të pakontrollueshme dhe ethe me temperaturë shumë të lartë, të cilat sidoqoftë nuk çojnë në komplikime. Vaksinimi kundër kollës së mirë mund t'u soministrohet edhe fëmijëve me probleme neurologjike, sipas vlerësimit paraprak nga mjeku, me kusht që këto çrregullime të jenë të stabilizuara.

## Hemofilia (HIB)

Hemofili b (Haemophilus influenzae tip b) është një bakter që normalisht gjendet në fyt ose hundë, ku nuk jep asnjë shqetësim, dhe që transmetohet nga një person tek tjetri nëpërmjet ajrit. Pothuajse të gjithë fëmijët ndeshen herët a vonë me hemofilin dhe zakonisht ky kontakt nuk shkakton ndonjë dëm, por, **nganjëherë, në 5 vitet e para të jetës dhe në veçanti në 2 vitet e para, mund të shkaktojë sëmundje shumë serioze. Ndër këto, më e shpeshta është meningjiti**, që edhe sot ndonjëherë është vdekjeprurëse dhe që mund të shkaktojë dëme të rënda të përhershme si epilepsi, shurdhësi, verbëri, paralizë dhe prapambetje mendore. Herë të tjera hemofili godet fytin dhe mund të shkaktojë inflamacion aq të rëndë (epiglotit) sa rrezikon vdekjen nga marrja e frymës, ose mund të godasë mushkëritë, zemrën ose kockat duke shkaktuar patologji të rënda si bronkopneumoni dhe perikardit; nëse bakteri arrin gjakun, kjo gjë mund të përfshijë krejt organizmin (sepsi).

Të gjithë fëmijët mund të sëmuren nga infeksione të rënda që shkaktohen nga hemofili, por megjithatë disa kanë një rrezik më të lartë:

- fëmijët me mangësi imuniteti, nga sëmundjet ose ilaçet;
- fëmijët pa shpretkë ose me shpretkë që nuk funksionon;
- fëmijët që vuajnë nga leucemia ose tumore të tjera, apo nga disa sëmundje kongjenitale (të lindura);
- fëmijët që jetojnë në familje të mëdha dhe ato që frekuentojnë çerdhen, për shkak të kontakteve të shpeshta me fëmijët e tjerë.

**Rastet e sëmundjes së rëndë nga hemofili b kanë rënë ndjeshëm në të gjithë Italinë pas futjes së vaksinimit në gjysmën e dytë të viteve '90, dhe meningjitet nga hemofili b në fëmijë praktikisht janë zhdukur; ata pak raste që ende verifikohen kanë të bëjnë me individët të cilët nuk janë vaksinuar.**

**HEMOFILI B TE FËMIJËT MUND TË SHKAKTOJË PATOLOGJI TË RËNDA, NDËRMJET TË CILAVE MENINGJITIN.**

# Hemofilia (HIB)

## VAKSINA

**VAKSINA ËSHTË MJETI I VETËM PËR TË PARANDALUAR INFEKSIONET MË TË RËNDA NGA HEMOFILIA.**

**VAKSINIMI REKOMANDOHET DHE ËSHTË FALAS PËR TË GJITHË FËMIJËT DERI NË MOSHËN 5 VJEÇ DHE PËR TË GJITHË PERSONAT ME RREZIK TË LARTË PATOLOGJISH OSE KUSHTESH.**

EKZISTON GJITHASHTU NJË VAKSINË MONOVALENTE, POR PËR TË SAPOLINDURIT NORMALISHT PËRDORET VAKSINA E KOMBINUAR HEKZAVALENTE (SHIH "VAKSINAT E KOMBINUARA", FAQE 5).

**EFIKASITETI I VAKSINIMIT KUNDËR HEMOFILISË ËSHTË SHUMË I LARTË, I BARABARTË ME 99%. RASTET E PAKTA TË MENINGJITIT NGA HEMOFILIA B KANË TË BËJNË ME FËMIJËT E PA VAKSINUAR.**

## EFEKTET ANËSORE

**Tek fëmijët vakcina tolerohet mirë dhe efektet anësore janë të rralla dhe të lehta.** Nganjëherë në pikën e soministrimit mund të verifikohet skuqje, ënjtje ose dhimbje. Efektet e tjera të zakonshme janë ethet, zakonisht jo e lartë, nervozizëm, përgjumje, të vjella ose diarre, përgjithësisht në 48 orët e para të vaksinimit.

# Fruthi

**Fruthi është një nga sëmundjet virale më ngjitëse dhe aktualisht është një nga shkaqet më të shpeshta të sëmundjes, si dhe të vdekjes, tek fëmijët në të gjithë botën.** Fruthi transmetohet me rrugë ajrore nëpërmjet sekrecioneve të hundës, gojës dhe fytit dhe manifestohet me ethe me temperaturë të lartë, kollë të vazhdueshme, sekrecione hundësh, konjunktivit dhe shfaqjen e njollave rozë në lëkurë (ekzantemë). Në rreth 30% të rasteve, me frekuencë më të madhe tek fëmijët shumë të vegjël dhe të rriturit, mund të zhvillohen komplikime për të cilat kërkohet shtrimi në spital. Kryesoret janë diarreja, otiti, pneumonia, konvulsionet, trombocitopenia (ulja drastike e numrit të trombociteve dhe si pasojë hemorragjitë), keratiti (i cili mund të lërë dëme në shikim) dhe encefaliti. Shumë rrallë fruthi mund të shkaktojë PESS (panencefalit sklerozues subakut), një patologji që pas disa vitesh mund të shkaktojë një dëm serioz të pakthyeshëm të trurit. Në vendet ku vaksinimi ka kohë që është i përhapur, PESS pothuajse është zhdukur.

**Nuk ka terapi për fruthin, përveç ilaçeve simptomatike, dhe parandalimi në formën e vaksinimit ka disa vite që është praktikuar në të gjithë botën me rezultate të rëndësishme.**

Duke qenë një sëmundje jashtëzakonisht ngjitëse, angazhimi për vaksinim duhet të vazhdojë dhe të intensifikohet, pasi **për të shmangur epidemitë, duhet të vaksinohet me 2 doza më shumë se 95% e popullsisë.** Është e mjaftueshme që kjo përqindje të bjerë paksa, për të parë krijimin e vatrave të reja të epidemive.

**MBROJTJA NGA FRUTHI  
ARRIN 99% TE  
TË VAKSINUARIT!.**

# Fruthi

Në asnjë vend të zhvilluar problemi nuk përfaqësohet nga disponueshmëria e vaksinës ose nga pamjaftueshmëria e strukturave sanitare, por përkundrazi është e tipit social dhe kulturor, pasi është shtuar numri i familjeve që refuzojnë vaksinimin, duke nënvlerësuar rrezikun e komplikimeve të mundshme; kështu fruthi po fillon të rishfaqet edhe në vendet e zhvilluara, duke përfshirë edhe ata që i ishin afruar eliminimit të tij.

## VAKSINA

VAKSINA KUNDËR FRUTHIT PËRMBAN VIRUSIN E GJALLË TË LIGËSHTUAR, PRA TË DOBËSUAR, POR DUKE E LËNË AQ TË AFTË SA PËR TË STIMULUAR MBROJTJET KUNDËR INFEKSIONIT.

**ZAKONISHT PËRDORET VAKSINA E KOMBINUAR TRIVALENTE MPR, FRUTH-SHYTA-ROZOLI OSE TETRAVALENT MPRV, FRUTH-SHYTA-ROZOLI-VARICELË (SHIH "VAKSINAT E KOMBINUARA", FAQE 5).**

**VAKSINIMI MPR OSE MPRV U OFROHET TË GJITHË FËMIJËVE NDËRMJET MOSHËS 12 DHE 15 MUAJ TË JETËS (DOZA E 1-RË) DHE 5-6 VJEÇ (DOZA E 2-TË).**

PËR FRUTHIN, MBROJTJA QË ARRIHET PAS DOZËS SË PARË ËSHTË RRETH 95% DHE ARRIN 99% ME TË DYTËN. VAKSINIMI I KRYER BRENDË 72 ORËVE NGA EKSPOZIMI NDAJ NJË RASTI TË SËMUNDJES MUND TË MBROJË NGA INFEKSIONI OSE T'JU BËJË TË SËMURENI NË FORMË MË TË LEHTË. VAKSINIMI MUND TË BËHET NË ÇDO MOSHË: REKOMANDOHET DHE ËSHTË FALAS EDHE TEK ADOLESHENTËT DHE TË RRITURIT QË NUK JANË VAKSINUAR MË PARË, SI DHE NË GRATË NË MOSHËN E RIPRODHIMIT.

## EFEKTET ANËSORE

**Në përgjithësi vakcina tolerohet mirë, efektet anësore më të shpeshta janë skuqja dhe ënjtja në pikën e soministrimit, të cilat sidoqoftë zhduken shpejt.** 5-14 ditë pas vaksinimit mund të shfaqen ethe të lehta ose simptoma të tjera të lehta që lidhen me sëmundje të tilla si ekzantema dhe ënjtja e shytave. Shumë rrallë mund të shfaqen konvulsione febrile, shumë më të shpeshta në rast sëmundjeje. 1-3 javë pas vaksinimit, mund të shfaqet rrallë herë te fëmijët dhe më shpesh te gratë adoleshente dhe të rritura, mund të shfaqen dhimbje të kyçeve të cilat zhduken në një kohë të shkurtër. Edhe më rrallë ndodh një rënie e përkohshme e pllakëzave (trombocitopeni) gjatë 2 muajve pas vaksinimit, ky ndërlikim ndodh dhjetë herë më shpesh pas sëmundjes natyrale. **Është vërtetuar shkencërisht që vakcina kundër fruthit-shytave-rozolisë (MPR) nuk shkakton, nuk stimulon e as nuk kontribuon në asnjë mënyrë në lindjen e sindromave të spektrit të autizmit.**

# Parotite

**Parotite epidemike, njihet në përgjithësi si "shytat", sëmundja shfaqet zakonisht me ënjtje të dhimbshme të gjëndrave të pështymës që gjenden përpara dhe poshtë veshit (parotide).**

Mund të zmadhohet njëra ose të dy gjëndrat parotide, edhe gjëndrat e tjera të pështymës, duke shkaktuar si pasojë dhimbje gjatë përtypjes dhe gëlltitjes. Shpesh sëmundja shoqërohet me dhimbje koke, dhimbje barku dhe ethe. Virusi i shytave përhapet nëpërmjet pikave të pështymës së infektuar ose me kontakt të drejtpërdrejtë me materialin e kontaminuar nga vetë pështyma; sëmundja transmetohet vetëm nga një person në tjetrin.

**SA MË I MADH TË JETË NUMRI I NJERËZVE TË PAMBROJTUR, AQ MË I MADH ËSHTË RREZIKU I EPIDEMIVE.**

Arsyeja pse është futur vaksinimi kundër parotides epidemike është se komplikimet që lidhen me sëmundjen janë të shpeshta. Në fakt, shpesh ka një përfshirje të sistemit nervor qendror, është i shpeshtë pankreatiti, është i mundur shurdhimi i përhershëm dhe, nëse infeksioni kontraktohet tek meshkujt pas pubertetit, në 20-50% të rasteve ekziston rreziku i orkitit (pezmatimi i testikujve që mund të sjellë si pasojë infertilitetin), tek gratë, më rrallë, mund të përfshijë vezoret.

Rreziku i kontraktimit të sëmundjes është i lidhur me mundësinë e përhapjes së virusit në popullsi: sa më shumë persona janë të pambrojtur, aq më lehtë mund të shfaqen epidemitë.

## VAKSINA

VAKSINA KUNDËR SHYTAVE (PAROTITE) PËRMBAN VIRUSIN E GJALLË TË LIGËSHTUAR, PRA TË DOBËSUAR, POR DUKE E LËNË AQ TË AFTË SA PËR TË STIMULUAR MBROJTJET KUNDËR INFEKSIONIT. PËRDORET VAKSINA E KOMBINUAR TRIVALENTE MPR, FRUTH-SHYTA-ROZOLI OSE TETRAVALENT MPRV, FRUTH-SHYTA-ROZOLI-VARICELË (SHIH "VAKSINAT E KOMBINUARA", FAQE 5).

**VAKSINIMI MPR OSE MPRV U OFROHET TË GJITHË FËMIJËVE NDËRMJET MOSHËS 12 DHE 15 MUAJSH TË JETËS (DOZA E 1-RË) DHE 5-6 VJEÇ (DOZA E 2-TË).**

PËR SHYTAT, MBROJTJA NUK ËSHTË AQ E MADHE SA PËR FRUTHIN DHE ROZOLINË, MEGJITHATË NË VENDET KU JANË BËRË GJERËSISHT VAKSINIME, SËMUNDJA ËSHTË ULUR NË MËNYRË DRASTIKE. VAKSINIMI REKOMANDOHET NË ÇDO MOSHË.

## EFEKTET ANËSORE

**Në përgjithësi vakcina tolerohet mirë, efektet anësore më të shpeshta janë skuqja dhe ënjtja në pikën e soministrimit, të cilat sidoqoftë zhduken shpejt.** 5-14 ditë pas vaksinimit mund të shfaqen ethe të lehta ose simptoma të tjera të lehta që lidhen me sëmundje të tilla si ekzantema dhe ënjtja e shytave. Shumë rrallë mund të shfaqen konvulsione febrile, shumë më të shpeshta në rast sëmundjeje. 1-3 javë pas vaksinimit, shumë rrallë tek fëmijët dhe më shpesh te gratë adoleshente dhe të rritura, mund të shfaqen dhimbje të kyçeve të cilat zhduken në një kohë të shkurtër. Edhe më rrallë ndodh një rënie e përkohshme e pllakëzave (trombocitopeni) gjatë 2 muajve pas vaksinimit, ky ndërlikim ndodh dhjetë herë më shpesh në qoftë se sëmuremi në mënyrë natyrale. **Është vërtetuar shkencërisht që vakcina kundër fruthit-shytave-rozolisë (MPR) nuk shkakton, nuk stimulon e as nuk kontribuon në asnjë mënyrë në lindjen e sindromave të spektrit të autizmit.**

# Rozolia

Rozolia (rubeola) është një sëmundje heksantematike infektive që shkaktohet nga Rubella virus, dhe **transmetohet nga një individ i infektuar te një person i shëndetshëm që preket nëpërmjet pikave që lëshohen nga kollitja, teshtitja ose thjesht duke folur**. Virusit është në gjendje të kalojë nëpër placentë, prandaj një grua e ndjeshme që kontraktonte rubeolën (rozolinë) gjatë shtatzënisë mund ta transmetojë infeksionin e saj te fëmija. Vaksinimi është futur për të mbrojtur të porsalindurit që ende nuk janë vaksinuar dhe për të eliminuar rubeolën kongjenitale: **nëse rubeola është kontraktuar gjatë shtatzënisë, veçanërisht në javët e para, mund të shkaktojë abort spontan, vdekje intrauterine ose keqformime të rënda të fetusit**, të cilat shfaqen tek i porsalinduri me defekte të shikimit, shurdhim, keqformime të zemrës dhe prapambetje mendore.

**Për të kontrolluar nëse jemi të mbrojtur nga rubeola (rozolia) mjafton vetëm një prelevim i thjeshtë gjaku (rubeo-test), që u këshillohet të gjitha grave përpara shtatzënisë;** analiza ofrohet falas sipas ligjit për mbrojtjen e amësisë. Dikur vaksinimi u propozojë vetëm vajzave dhe grave në moshë pjellore të pambrojtura, por strategjia nuk ka funksionuar sepse virusi vazhdonte të qarkullonte te meshkujt dhe në të njëjtën kohë nuk ishte e mundur të vaksinohet 100% e grave të prekshme. E vetmja strategji efiçente është vaksinimi i të paktën 95% të fëmijëve, djem dhe vajza, në mënyrë që të eliminohet plotësisht qarkullimi i virusit në popullatë. Ky objektivi nuk është arritur akoma dhe rozolia (rubeola), ashtu si fruthi, vazhdon të qarkullojë në nivel evropian.

Nuk është gjithmonë e lehtë të bësh një diagnozë të rozolisë, në fakt në shumicën e rasteve sëmundja është aq e lehtë sa kalon pa u vënë re. Nganjëherë shfaqet me ethe modeste, me zmadhim të përgjithshëm të gjëndrave, kryesisht në fyt dhe në qafë, dhe me shfaqjen e njollave rozë në lëkurë për një periudhë të shkurtër. Për t'u siguruar që kemi pasur rozolinë është pra e nevojshme të kryejmë një analizë gjaku, pasi të njëjtat simptoma mund të shkaktohen edhe nga viruse të tjerë.

MËNYRA E VETME PËR TË PARANDALUAR EPIDEMITË ËSHTË VAKSINIMI I TË PAKTËN 95% TË FËMIJËVE.

## VAKSINA

VAKSINA KUNDËR ROZOLISË PËRMBAN VIRUSIN E GJALLË TË LIGËSHTUAR, PRA TË DOBËSUAR, POR DUKE E LËNË AQ TË AFTË SA PËR TË STIMULUAR MBROJTJET KUNDËR INFEKSIONIT.

NUK EKZISTON NJË VAKSINË E VETME PRANDAJ PËRDORET VAKSINA E KOMBINUAR TRIVALENTE MPR, FRUTH-SHYTA-ROZOLI OSE TETRAVALENTE MPRV, FRUTH-SHYTA-ROZOLI-VARICELË (SHIH "VAKSINAT E KOMBINUARA", FAQE 5).

VAKSINIMI MPR OSE MPRV U OFROHET TË GJITHË FËMIJËVE NDËRMJET 12 DHE 15 MUAJVE TË JETËS (DOZA E 1-RË) DHE 5-6 VJEÇ (DOZA E 2-TË).

**VAKSINA ANTI-ROZOLI ËSHTË TEPËR EFIKASE DHE GARANTON NJË MBROJTJE AFATGJATË ME 95-100%.**

**VAKSINIMI MUND TË BËHET NË ÇDO MOSHË.**

## EFEKTET ANËSORE

**Në përgjithësi vakcina tolerohet mirë, efektet anësore më të shpeshta janë skuqja dhe ënjtja në pikën e soministrit, të cilat sidoqoftë zhduken shpejt.** 5-14 ditë pas vaksinimit mund të shfaqen ethe ose simptoma të tjera që lidhen me sëmundje të tilla si ekzantema dhe ënjtja e shytave (parotide). Shumë rrallë mund të shfaqen konvulsione febrile. 1-3 javë pas vaksinimit, shumë rrallë tek fëmijët dhe më shpesh te gratë adoleshente dhe të rritura, mund të shfaqen dhimbje të kyçeve të cilat zhduken në një kohë të shkurtër. Edhe më rrallë ndodh një rënie e përkohshme e pllakëzave (trombocitopeni) gjatë 2 muajve pas vaksinimit, ky ndërlikim ndodh dhjetë herë më shpesh në qoftë se sëmundja në mënyrë natyrale. **Është vërtetuar shkencërisht që vakcina kundër fruthit-shytave-rozolisë (MPR) nuk shkakton, nuk stimulon e as nuk kontribuon në asnjë mënyrë në lindjen e sindromave të spektrit të autizmit.**

# Varicela

**Varicela është një sëmundje infektive shumë ngjitëse** që shkaktohet nga virusi *Varicella zoster*, dhe manifestohet me shfaqjen e njollave ngjyrë rozë që kruhen mbi lëkurë e që evoluojnë me shpejtësi në fshikëza, pastaj në puçrra dhe më në fund në dregëza, që janë të destinuara të bien.

**Virusi mund të transmetohet nga pacienti me anën e pikave që lëshohen gjatë frymëmarrjes dhe duke folur ose nëpërmjet likuidit që përmbajnë fshikëzat, me kontakt të drejtpërdrejtë ose me shpërndarje në ajër;** kjo mund të ndodhë rreth dy ditë përpara shfaqjes së fshikëzave deri në shfaqjen e dregëzave.

**Gjatë shtatzënisë, virusi mund të transmetohet në embrion ose në fetus nëpërmjet placentës duke shkaktuar sindromën e varicelës kongjenitale.** Në qoftë se përkundrazi nëna preket nga sëmundja gjatë një periudhe pesë ditë përpara lindjes e dy ditë pas lindjes së fëmijës, mund të verifikohet një formë serioze e varicelës e të porsalindurit, vdekshmëria e të cilës mund të arrijë deri në 30%. Sëmundja mund të shoqërohet me ethe dhe dobësi.

Sëmundja mund të jetë veçanërisht e rëndë nëse prek personat me imunodepresion sepse mund të çojë në pneumoni dhe sëmundje të tjera të rënda. Ndër komplikimet e rralla neurologjike, më i zakonshmi është inflamacioni i trurit të vogël që shkakton çrregullime të ekuilibrit, por që zakonisht zhduket pa lënë dëme.

Pas shërimit, virusi nuk eliminohet nga organizmi i infektuar dhe mbetet i fshehtë në nivelin e strukturave specifike nervore gjatë gjithë jetës.

**Në 10-20% të rasteve virusi zgjohet pas disa vitesh ose dekadash, zakonisht pas moshës 50 vjeç, duke krijuar herpes zoster,** i njohur zakonisht si "zjarmi i Shna Ndout", i cili shfaqet me fshikëza dhe dregëza të ngjashme me ato të varicelës por që zakonisht lokalizohen përgjatë rrugës së një nervi (kryesisht të gjoksit dhe kokës), dhe që mund të shoqërohet me dhimbje të forta. Herpes zoster është më i shpeshtë nëse sëmundja kontraktohet gjatë vitit të parë të jetës, nga ku rrjedh rëndësia që të vaksinohen fëmijët e parë të një gruaje shtatzënë.

## VAKSINA

VAKSINA KUNDËR VARICELËS PËRMBAN VIRUSIN E GJALLË TË LIGËSHUAR, PRA TË DOBËSUAR, POR DUKE E LËNË AQ TË AFTË SA PËR TË STIMULUAR MBROJTJET KUNDËR INFEKSIONIT.

**SOMINISTROHET DUKE FILLUAR NGA MOSHA 12 MUAJSH.**

KËSHILLOHEN 2 DOZA VAKSINE: E PARA NDËRMJET MOSHËS 12 DHE 15 MUAJSH, E DYTA NË MOSHËN 5-6 VJEÇ. PAS DOZËS SË DYTË, MBROJTJA E MARRË ARRIN NË 99%.

VAKSINIMI I KRYER BRENDA 72 ORËVE (OSE MË SË SHUMTI 5 DITËSH) NGA EKSPOZIMI MUND TË MBROJË KUNDËR INFEKSIONIT OSE T'JU BËJË TË SËMURENI NË FORMË MË TË LEHTË.

**VAKSINA (2 DOZA TË PAKTËN 1 MUAJ LARG NJËRA TJETRËS) REKOMANDOHET EDHE NË SUBJEKTET ME FAKTORË RREZIKU,** SIÇ ËSHTË RASTI I BASHKËJETUESVE QË NDIKOHEN NGA PERSONAT E PREKUR NGA IMUNODEPRESIONI I RËNDË DHE TEK GRATË NË MOSHË PJELLORE QË NUK E KANË PASUR SËMUNDJEN, PËR TË SHMANGUR NJË INFEKSION TË MUNDSHËM GJATË SHTATZËNISËSË DHE SI PASOJË DËMTIMET TE FËMIJA.

## Varicela

**VAKSINIMI REKOMANDOHET GJITHASHTU TEK ADOLESHENTËT DHE TE TË RRITURIT E PREKSHËM PA KUNDËRINDIKACIONE, VEÇANËRISHT PËR ATA QË PËR ARSYE PROFESIONALE KANË NJË RREZIK MË TË MADH TË MARRJES SË INFEKSIONIT** (P.SH. PERSONELI SHKOLLOR) OSE T'UA TRANSMETOJNË ATË PERSONAVE ME RREZIK TË LARTË NDAJ KOMPLIKIMEVE SERIOZE (P.SH. OPERATORËT SANITARË). VAKSINA KUNDËR VARICELËS MUND TË SOMINISTROHET NË FORMULIMIN TETRAVALENT MPRV (SHIH "VAKSINAT E KOMBINUARA", FAQE 5) PËR T'U SOMINISTRUAR NË MOSHËN 13-15 MUAJSH DHE 5-6 VJEÇ, POR ËSHTË GJITHASHTU NË DISPOZICION NË NJË FORMULIM TË VETËM.

### EFEKTET ANËSORE

**Vaksina kundër varicelës është e sigurt dhe në përgjithësi tolerohet mirë.** Efektet negative më të shpeshta janë lokale (skuqje, ënjtje dhe dhimbje në pikën e soministrimit) dhe me pak rëndësi, me zgjidhje spontane dhe pa pasoja. Pas 5-14 ditësh mund të shfaqen ethe dhe/ose disa fshikëza. Përqindja e efekteve të dëmshme të rënda është jashtëzakonisht e rrallë. Soministrimi i dozës së parë të vaksinës së kombinuar MPRV shoqërohet me një rrezik të shtuar të mundshëm të konvulsioneve febrile. Prandaj, në rastin e një anamneze para-vaksinimi pozitive për konvulsione febrile të përparshme te subjekti ose te anëtarët e familjes në brezin e parë, këshillohet që të përdoren të dyja vaksinat veç e veç (MPR + V). Bëhet fjalë sidoqoftë për reaksione të rralla që nuk përjashtojnë indikacionin për përdorimin e vaksinës tetraivalente.

## Pneumokoku

Sëmundjet nga pneumokoku janë të përhapura në të gjithë botën. Pneumokokët (*Streptococcus pneumoniae*) janë një familje mikrobesh nga të cilët janë të njohur më shumë se 90 sierotipa, por vetëm një pjesë e tyre është në gjendje të shkaktojë forma invazive infeksioni që mund të përparojnë në meningjit ose në sepsi (pushtim i baktereve në gjak me rezultate shpesh vdekjeprurëse). Në vendet më të varfra ky fenomen arrin dimensione dramatike: rreth 1 milion vdekje çdo vit. Sierotipat e pneumokokut që shkaktojnë këto infeksione të rënda mund të ndryshojnë në zona të ndryshme gjeografike dhe madje mund të ndryshojnë edhe me kalimin e kohës.

Mikrobet mund të lokalizohen në fytin dhe hundën e njerëzve pa shkaktuar shqetësime, ose mund të shkaktojnë çrregullime jo të rënda por të shpeshta siç janë otitet, sinusitet dhe bronkitet. **Në rast se mikrobet riprodhohen në zonat e trupit, ku ata zakonisht nuk janë të pranishëm, si gjaku, likuidi cefalorakidian (likuor) ose mushkëritë, sëmundja manifestohet në një formë të rëndë, me kuadro përkatësisht të sepsit, meningjtit dhe pneumonisë.**

**Transmetimi ndodh nëpërmjet pikave të pështymës dhe mukusit që lëshohet nga teshtitjet, kollitjet ose thjesht duke folur me njerëzit që janë mbartës të bakterit.** Në fakt, rastet e sëmundjes verifikohen kryesisht në dimër, kur sindromat e ftohjes dhe të gripit janë të shpeshta. Fëmijët më të vegjël se 5 vjeç dhe aq më tepër ata që janë më të vegjël se 2 vjeç, si dhe të moshuarit dhe ata persona, mbrojtja imunitare e të cilëve është e komprometuar, ka më shumë të ngjarë që të sëmuren dhe të zhvillojnë forma të rënda. Edhe fakti i frekuentimit të çerdheve dhe shkollave paraqet një faktor rreziku. **Pas futjes së vaksinimit, rastet e meningjtit tek fëmijët nën 5 vjeç janë ulur ndjeshëm, veçanërisht në Emilia-Romagna rënia ka qenë rreth 60%.**



# Pneumokoku

## VAKSINA

**EKZISTOJNË DY TIPOLOGJI VAKSINASH KUNDËR PNEUMOKOKUT,** TË DYJA TË BAZUARA NË INDUKSIONIN E NJË PËRGJIGJEJE IMUNE KUNDREJT POLISAKARIDEVE QË PËRBËJNË KAPSULËN: VAKSINA POLISAKARIDE 23-VALENTE DHE VAKSINAT E KONJUGUARA 10-VALENTE DHE 13-VALENTE. VAKSINAT E KONJUGUARA, D.M.TH. TË BASHKUARA ME NJË PROTEINË PËR TË FUQIZUAR EFEKTIN, JANË EFIKASE QYSH NË 2 MUAJT E PARË TË JETËS DHE MBROJNË KUNDËR SIEROTIPAVE QË PËRFSHIHEN MË SHPESH NË RASTET E SËMUNDJES INVAZIVE. **KAPACITETI I TYRE PËR TË PARANDALUAR INFEKSIONET MË TË RËNDA ARRIN NJË MBROJTJE POTHUAJSE 100%;** MBROJTJA NGA PNEUMONIA DHE OTITET ËSHTË MË E ULËT, POR KARAKTERISTIKAT E TYRE GARANTOJNË MBROJTJE PËR NJË KOHË TË GJATË (“MEMORIA IMUNOLOGJIKE”).

VAKSINA 23-VALENTE ËSHTË E AUTORIZUAR VETËM PËR FËMIJËT ME MOSHË MBI 2 VJEÇ SEPSE, MEGJITHËSE MBRON NGA NJË NUMËR MË I MADH I SIEROTIPAVE, NUK ËSHTË E KONJUGUAR DHE PËR KËTË ARSYE NUK ËSHTË E AFTË TË STIMULOJË MBROJTJET TE FËMIJËT MË TË VEGJËL.

KJO VAKSINË KËRKON NJË PËRSËRITJE 3-5 VJEÇARE, NUK LË MEMORIE IMUNOLOGJIKE DHE KËSHILLOHET VETËM PËR TË FUQIZUAR MBROJTJEN TE SUBJEKTET ME SËMUNDJE TË VEÇANTA QË RRISIN RREZIKUN E INFEKSIONIT TË RËNDË TË PNEUMOKOKUT.

**VAKSINIMI KUNDËR PNEUMOKOKUT NËPËRMJET VAKSINËS SË KONJUGUAR REKOMANDOHET DHE OFROHET FALAS PËR TË GJITHË TË PORSALINDURIT** ME 3 DOZA NË VITIN E PARË TË JETËS **DHE PËR PERSONAT E ÇDO MOSHE ME KUSHTE RREZIKU** QË RRISIN MUNDËSINË E KOMPLIKIMEVE TË RËNDA. QË PREJ VITIT 2017, VAKSINA I OFROHET EDHE GRUPIT TË 65-VJEÇARËVE.

PËR KATEGORITË NË RREZIK PËRDOREN TË DYJA VAKSINAT NË SEKUENCË (SË PARI 13-VALENTE, PASTAJ 23-VALENTE) PËR TË SHTRIRË MBROJTJEN NDAJ NJË NUMRI MË TË MADH TË PNEUMOKOKËVE.

## EFEKTET ANËSORE

**Të dy vaksinat tolerohen mirë,** nganjëherë paraqiten çrregullime të tilla si skuqje, ënjtje dhe dhimbje në vendin e soministrimit, ose fëmija mund të jetë më i irrituar ose i më përgjumur se zakonisht. Ethet, vështirë se ngrihet temperatura, si dhe dhimbja e kokës ose dobësia, ndodhin rrallëherë. Edhe më rrallë mund të shfaqen konvulsione si rrjedhim i etheve.

# Meningokoku

Meningokoku (*Neisseria meningitidis*) mund të jetë i pranishëm në fytin dhe në hundën e shumë personave (deri në 30% të popullsisë) pa shkaktuar shqetësime, por, në disa raste, mund të arrijë në meningje ose të përhapet në të gjithë organizmin duke shkaktuar infeksione shumë të rënda (meningjite ose sepsi) ose më rrallë pneumoni, artrite, otite dhe epiglote. **Transmetimi ndodh me anën e pikave të lëshuara nga hunda dhe goja e personave të infektuar ose mbartës.** Grupmosha më e prekur absolutisht është ajo nën 5 vjeç, e ndjekur nga adoleshentët dhe të rinjtë e rritur deri moshën 25 vjeç. Meningjiti shfaqet me ethe të lartë papritmas, dhimbje koke të fortë, ngurtësi në qafë, konvulsione, neveri (të përziera), të vjella, fotofobi dhe alterim të vetëdijes. **Nëse diagnoza është bërë në kohën e duhur, mundësitë e kurimit, nëpërmjet terapisë me antibiotikë, janë shumë më të përmirësuara në krahasim me të kaluarën.** Përveç kësaj, për ata që kanë pasur kontakte të ngushta me një të sëmurë, marrja e antibiotikëve për këtë qëllim mund të parandalojë dhe ndërpresë transmetimin e infeksionit.

**Pavarësisht nga përparimi mjekësor, sëmundja e shkaktuar nga meningokoku mund të ketë nganjëherë pasoja shumë serioze ose madje të çojë deri në vdekje (10-15% të rasteve).** Në rast mbijetese, mund të ndodhin komplikime të tilla si amputimet e gjymtyrëve ose segmente të gjymtyrëve, sëmundje të sistemit nervor (paralizë, konvulsione ose iktus), shurdhësi, shqetësime të sferës psiko-afektive dhe prapambetje mendore. Njihen trembëdhjetë lloje meningokoku, por vetëm pesë (A, B, C, W-135, Y) janë të aftë të shkaktojnë sëmundje invazive dhe epidemi. Nga këto, dy (B dhe C) janë përgjegjës për shumicën e rasteve në Itali, Evropë dhe Amerikë, megjithëse rastet nga tipat Y dhe W135 janë gjithashtu në rritje.

VAKSINA ËSHTË E DETYRUESHME PËR PELEGRINËT (HAXHI) QË SHKOJNË NË MEKË.

## VAKSINA

VAKSINAT KUNDËR MENINGOKOKËVE PËRFTOHEN NGA FRAGMENTET E BAKTERIT DHE PËR KËTË ARSYE NUK MUND TË SHKAKTOJNË SËMUNDJEN. JANË TË DISPONUESHME TRE TIPA VAKSINASH DHE TË GJITHA SOMINISTROHEN ME RRUGË INTRAMUSKULORE:

- **VAKSINA E KONJUGUAR TETRAVALENTE** KUNDËR TIPAVE A, C, W-135 DHE Y, QË MUND TË PËRDORET PAS VITIT TË PARË TË JETËS;
- **VAKSINA KUNDËR MENINGOKOKUT B**, QË MUND TË SOMINISTROHET PASI TË JETË MBUSHUR MOSHA 2 MUAJSH;
- **VAKSINA E KONJUGUAR MONOVALENTE KUNDËR MENINGOKOKUT C**, E CILA MUND TË PËRDORET PASI TË JETË MBUSHUR MOSHA 2 MUAJSH.

VAKSINIMI KUNDËR MENINGOKOKUT ME VAKSINË TETRAVALENTE ACWY REKOMANDOHET DHE OFROHET FALAS PËR TË GJITHË FËMIJËT NDËRMJET MOSHËS 12 DHE 15 MUAJSH, ME NJË DOZË TË DYTË PËRFORCIMI NË MOSHËN 13-14 VJEÇ. VAKSINIMI KUNDËR MENINGOKOKUT B OFROHET FALAS NË VITIN E 1-RË TË JETËS NGA DATA 1/1/2017 DHE MUND TË KRYHET SIPAS REGJIMIT TË BASHKËNDARJES SË SHPENZIMIT NË MOSHAT VIJUESE ME KËRKESËN E PRINDËRVE. **TË DYJA VAKSINAT U OFROHEN FALAS PERSONAVE TË TË GJITHA MOSHAVE QË KANË MË SHUMË RREZIK TË SËMUREN RËNDË,** PËR SHEMBULL ATA QË VUAJNË NGA DISA PATOLOGJI KRONIKE QË DOBËSOJNË SISTEMIN IMUNITAR. VAKSINA TETRAVALENTE ACWY REKOMANDOHET GJITHASHTU PËR UDHËTARËT QË SHKOJNË NË ZONA ME RREZIK MË TË MADH PËR KATËR TIPAT E MENINGOKOKUT TË PËRFSHIRË, OSE PËR ATA QË QËNDROJNË PËR PERIUDHA TË GJATA NË KËTO VENDE.

## EFEKTET ANËSORE

Vaksinat tolerohen mirë, nganjëherë paraqiten çrregullime të tilla si skuqje, ënjtje dhe dhimbje në vendin e soministrit. Mund të shfaqen në mënyrë të përkohshme dhimbje koke, dhimbje të muskujve ose kyçeve dhe ethe, nganjëherë me temperaturë të lartë. Në disa raste, fëmijët më të vegjël mund të jenë të irrituar ose të përgjumur.

# Hepatiti A

## Hepatiti A është një sëmundje infektive virale që godet mëlçinë.

Virusi i hepatitit A transmetohet me rrugë orale-fekale: eliminohet pra me jashtëqitjet, si përpara ashtu edhe pas shfaqjes së simptomave, dhe **infeksioni ndodh nëpërmjet gëlltitjes së ujit ose të ushqimeve të papërpunuara të ndotura (perime, fruta të paqëruara, fruta deti), por edhe nga kontakti i drejtpërdrejtë nga personi në person.** Pas një periudhe inkubacioni që ndryshon nga 15 deri në 50 ditë, infeksioni mund të manifestohet me ethe, dobësi, shqetësime gastrointestinale dhe verdhëz (ngjyrë e verdhemë e syve dhe e lëkurës). Infeksioni tek të porsalindurit dhe fëmijët e vegjël është përgjithësisht i lehtë ose asimptomatik me një zhvillim benign, ndërsa fëmijët më të mëdhenj dhe të rriturit janë në rrezik që ta shfaqin sëmundjen në një formë më serioze me forma të rënda dhe për një kohë të gjatë e nganjëherë fatale (sidomos tek të rriturit). Pacientët që sëmuren dhe shërohen nuk mbeten mbartës të virusit.

**Hepatiti A është i përhapur në të gjithë botën, por kryesisht në vendet me kushte të këqija higjienike-sanitare ku shëndeti i ujit të pijshëm monitorohet në mënyrë të pamjaftueshme.**

Ekziston një rrezik i konsiderueshëm i infeksionit në udhëtarët që shkojnë në vendet ku sëmundja është shumë e përhapur (Amerika Qendrore dhe Jugore, Afrika, Lindja e Mesme, Azia dhe Paqësori Perëndimor). **Hepatiti A është një sëmundje e që mund të parandalohet me anën e vaksinimit,** që u këshillohet udhëtarëve që shkojnë në zonat e rrezikut së bashku me normat korrekte higjienike-sanitare. **Vaksinimi rekomandohet gjithashtu për personat e prekur nga sëmundjet hepatike kronike, për ata që punojnë në ambiente në kontakt me virusin, personave toksiko-dipendent dhe për kontaktet familjare të subjekteve me hepatit akut A.** Rajoni Emilia-Romagna rekomandon ofertën aktive dhe falas për fëmijët nën moshën 6 vjeç, të cilët udhëtojnë në vendet e huaja dhe rajonet italiane, ku sëmundja është shumë e përhapur.

Vaksinimet në fëmijëri dhe në adoleshencë | 34

**Shumë të rëndësishme janë normat e përgjithshme të higjienës për parandalimin e infeksioneve oralo-fekale** (higjiena personale, larja dhe zierja e perimeve dhe e molusqeve, etj.) dhe kontrolli i kultivimit dhe i tregtimit të frutave të detit.

## VAKSINA

VAKSINA PËRBËHET NGA VIRUSE TË ÇAKTIVIZUAR (D.M.TH. TË MBYTUR) DHE SOMINISTROHET ME RRUGË INTRAMUSKULORE.

**REKOMANDOHET PAS MBUSHJES SË MOSHËS 1 VJEÇ, NË 2 DOZA TË PAKTËN 6 MUAJ LARG NGA NJËRA TJETRA, TË CILAT GARANTOJNË NJË MBROJTJE TË QËNDRUESHME.**

**VAKSINA ËSHTË JASHTËZAKONISHT E EFIKASE DHE E SIGURT, DHE ËSHTË NË GJENDJE TË SIGUROJË MBROJTJE TË MIRË NËSE SOMINISTROHET 2-4 JAVË PARA SE TË UDHËTOJMË NË NJË ZONË ME RREZIK.**

## EFEKTET ANËSORE

**Vaksina tolerohet mirë.** Janë të mundshme reaksione të lehta lokale në pikën e soministrit, të tilla si dhimbje, skuqje, ënjtje dhe/ose reaksione të përgjithshme për një kohë të shkurtër si dhimbja e kokës, dobësi e përgjithshme dhe ethe.

HEPATITI A ËSHTË NJË  
SËMUNDJE SHUMË E PËRHAPUR  
NË TË GJITHË BOTËN DHE  
ËSHTË E RËNDËSISHME TË  
VAKSINOHEMI PËRPARA SE TË  
UDHËTOJMË.

# Rotavirus

**Rotavirusi është shkaku më i zakonshëm i gastroenteritit (diarre dhe të vjella) pediatrik, veçanërisht në të porsalindurit dhe te fëmijët nën moshën pesë vjeç.** Fakti që jemi prekur nga virusi nuk jep një mbrojtje efikase kundër sëmundjes, megjithëse infeksionet që kontrahohen në vitet pasuese dhe në moshë madhore kanë tendencë të shfaqen në një formë më të lehtë. Bëhet fjalë për një sëmundje të përhapur në të gjithë botën; në Itali paraqitet me kulme, me përqindje sezonale në periudhën e dimrit, ndërmjet nëntorit dhe marsit.

**Rruga kryesore e transmetimit të virusit është ajo orale-fekale,** pra lëshohet në ambient nëpërmjet jashtëqitjeve të një subjekti të infektuar dhe pastaj futet në një person tjetër nëpërmjet gëlltitjes së ujit ose ushqimit të kontaminuar, por përhapja mund të ndodhë edhe nga kontakti dhe me rrugët e frymëmarrjes. **Përhapja nga një person në tjetrin nëpërmjet ndotjes së duarve është ndoshta më e përhapur në ambientet e komuniteteve, veçanërisht në ambientet e çerdheve për fëmijët.** Tek fëmijët e vegjël, gastroenteriti nga rotavirusi, në disa raste, mund të shkaktojë një formë të rëndë të diarresë të shoqëruar me dehidratim, që kërkon shtrimin në spital dhe mund të përparojë me shpejtësi dhe të jetë fatal në mungesë të një trajtimi adekuat mjekësor mbështetës, siç ndodh shpesh në vendet në zhvillim.

Pasi virusi të ketë hyrë në organizëm, virusit i duhen rreth dy ditë inkubacion për të dhënë simptomat: ethe e lehtë-mesatare, shqetësime në stomak, të vjella dhe diarre në formë uji. Në përgjithësi, sëmundja zgjat mesatarisht 3-8 ditë.

**Për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive me transmetim oralo-fekal në përgjithësi është thelbësore të mbajmë kushte të mira higjienike** si në shtëpi ashtu edhe në komunitetet

Vaksinimet në fëmijëri dhe në adoleshencë | 36

që frekuentohen nga fëmijët; është veçanërisht e rëndësishme larja e duarve, veçanërisht pas ndërrimit të pelenave. Këto rekomandime janë edhe më të vlefshme nëse kemi kontakte me subjekte imunodepresiv.

## VAKSINA

### **MËNYRA MË E MIRË PËR TË MBROJTUR FËMIJËN NGA FORMAT MË TË RËNDA TË SËMUNDJES NGA ROTAVIRUSI ËSHTË VAKSINIMI.**

VAKSINAT SOT NË DISPOZICION KANË DEMONSTRUAR NJË EFIKASITET TË PËRGJITHSHËM MË TË MADH SE 80% DHE NJË ZVOGËLIM TË FORMAVE MË TË RËNDA (ATO QË KËRKOJNË SHTRIMIN NË SPITAL) DERI NË 100%.

VAKSINA, E MARRË ME VIRUSE TË GJALLA, POR TË DOBËSUAR NË MËNYRË QË TË MOS SHKAKTOJË SËMUNDJEN, MERRET NGA GOJA DHE MUND TË SOMINISTROHET SË BASHKU ME VAKSINIMET E TJERA. JANË TË DISPONUESHME DY VAKSINA TË NDRYSHME KUNDËR ROTAVIRUSIT, NJËRA NË 2 DOZA DHE TJETRA NË 3 DOZA.

PËR TË DYJA VAKSINAT DOZA E PARË DUHET TË SOMINISTROHET DUKE FILLUAR NGA MOSHA 6 JAVËSHE DHE JO MË VONË SE 10-12 JAVËSHE, INTERVALI NDËRMJET DOZAVE DUHET TË JETË SË PAKU 4 JAVË, DHE CIKLI DUHET TË PËRFUNDOJË BRENDA MOSHËS 24 JAVËSHE.

PËR VAKSINËN ME 3 DOZA, DOZA E TRETË DHE E FUNDIT MUND TË SOMINISTROHET DERI NË MOSHËN 32 JAVËSHE.

## EFEKTET ANËSORE

Pas vaksinimit, fëmijët mund të tregojnë nervozizëm, humbje të oreksit, episode etesh, diarre dhe/ose të vjella. Shqyrtime të fundit kanë demonstruar se vaksinat aktualisht në përdorim nuk përcaktojnë një rrezik të shtuar të invaginacionit intestinal.

**VAKSINA ËSHTË EFIKASE 80%,  
POR I KA ZVOGËLUAR FORMAT E RËNDA  
TË GASTROENTERITIT DERI NË 100%.**

# Gripi

**Gripi (influenca) është një patologji me ecuri sezonale që shfaqet kryesisht në periudhën e dimrit, me një kulm ndërmjet dhjetorit dhe marsit.** Bëhet fjalë për një sëmundje akute të frymëmarrjes shumë ngjitëse që shkaktohet nga dy tipa të ndryshëm të virusit të gripit (tipi A dhe B) që çdo vit mund të modifikohen në një mënyrë pak a shumë të rëndësishme. Mbrojtjet e prodhuara kundër virusit të një viti më parë bëhen pra pak efikase kundrejt infeksionit të ri, kjo do të thotë se gripi nuk lë një memorie imunitare për të gjithë jetën, në kundërshtim me atë që ndodh për sëmundjet e tjera infektive. **Për të njëjtën arsye, përbërja e vaksinës duhet të azhurnohet çdo vit, duke e përshtatur atë me llojet virale që kanë pasur përhapjen më të madhe në periudhën e fundit të epidemisë.**

Vetëm në raste të rralla viruset e gripit ndryshojnë në mënyrë rrënjësore sa që bëhen "të panjohshëm", në këtë rast shfaqen epidemi të rënda që mund të përfshijnë krejtësisht planetin (pandemi). **Gripi transmetohet nga personi në person kryesisht nëpërmjet pikave të lëshuara gjatë frymëmarrjes (transmetim i drejtpërdrejtë), ose nëpërmjet objekteve të kontaminuara kohët e fundit me sekrecionet e hundës ose të fytit dhe, veçanërisht te fëmijët, nëpërmjet duarve të ndotura (transmetim indirekt).** Ambientet e mbyllura, të mbushura me njerëz dhe me ajrosje të keqe, siç janë autobusët, dyqanet, kinematë dhe sallat e shkollave, janë ata në të cilat sëmundja përhapet me lehtësi më të madhe sepse është më kollaj të hyjmë në kontakt me viruset. Gripi zakonisht ka një shfaqje të papritur me simptoma të përgjithshme dhe të frymëmarrjes: ethe e shoqëruar nga të dridhura, dhimbje kockash dhe muskujsh, dhimbje koke, rraskapitje të rëndë, humbje e oreksit, dhimbje të fytit dhe kollë. Ethet zakonisht zgjasin 2 deri në 3 ditë por mund të zgjasin më shumë.

Rrezikshmëria e sëmundjes mund të varet nga tipi i virusit në qarkullim, nga diversiteti i tij në lidhje me ata që kanë qarkulluar në vitet e kaluara, ose nga kushtet e subjektit të prekur. Çdo vit rreth 10% e popullsisë italiane sëmurët; grupmosha më e prekur është ajo pediatrike, veçanërisht nën 4 vjeç. Fëmijët, në fakt, kanë "ndeshur" pak viruse gripi gjatë jetës së tyre, prandaj ata nuk kanë zhvilluar ende mbrojtje të mjaftueshme imunitare dhe për këtë arsye sëmuren më shpesh sesa të rriturit; sidoqoftë shumë më rrallë paraqesin komplikime për shkak të sëmundjes. **Sëmundja, nga ana tjetër, mund të jetë më e rrezikshme nëse prek subjektet e moshuara ose me sëmundje kronike që i bëjnë ata më të ndjeshëm ndaj komplikimeve** (veçanërisht të tipit respirator, siç është p.sh. pneumonia) ose në një përkeqësim të sëmundjes nga e cila vuajnë. Gratë shtatzëna gjithashtu kanë një rrezik të shtuar për të zhvilluar rezultate të tipit kardio-respiratore; infeksioni gjithashtu mund të shkaktojë abort, vdekje neonatale, lindje të parakohshme dhe peshë të ulët në lindje.

## VAKSINA

**VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT, SË BASHKU ME MASAT HIGJENIKE-SANITARE AMBIENTALE DHE PERSONALE, ËSHTË MJETI MË EFIKAS DHE MË I SIGURT NË DISPOZICION PËR TË PARANDALUAR SËMUNDJEN DHE PËR TË MBROJTUR NË MËNYRË EFIKASE NGA KOMPLIKIMET.**

**VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT ËSHTË FALAS MBI MOSHËN 65 VJEÇ DHE PËR SUBJEKTET NË RREZIK, SI TEK TË RRITURIT ASHTU EDHE TE FËMIJËT.**

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT REKOMANDOHET DHE OFROHET FALAS ÇDO VIT PËR PERSONAT E TË GJITHA MOSHAVE NË KUSHTE TË DOBËTA SHËNDETËSORE, MBI 65 VJEÇ, GRA SHTATZËNA DHE OPERATORË SANITARË.

**ËSHTË E NEVOJSHME QË T'I NËNSHTROHEMI VAKSINIMIT KUNDËR GRIPIT, ÇDO VIT NË FILLIM TË SEZONIT TË RI TË EPIDEMIVE, NDËRMJET FILLIMIT TË NËNTORIT DHE FUNDIT TË DHJETORIT.**

VAKSINA SOMINISTROHET DUKE FILLUAR NGA GJASHTË MUAJT E JETËS, SIPAS NJË NUMRI TË NDRYSHUESHËM DOZASH:


- NJË DOZË E VETME NËSE FËMIJA ËSHTË MBI 9 VJEÇ OSE NË QOFTË SE ËSHTË VAKSINUAR VITIN E KALUAR;
- DY DOZA, 4 JAVË LARG NJËRA TJETRËS, NËSE FËMIJA ËSHTË MË PAK SE 9 VJEÇ DHE VAKSINOHET PËR HERË TË PARË.

**MBROJTJA FILLON RRETH 15 DITË PAS PËRFUNDIMIT TË VAKSINIMIT,** DHE PASTAJ ZVOGËLOHET NË 5/6 MUAJT E ARDHSHËM. EFIKASITETI I VAKSINIMIT KUNDËR GRIPIT MUND TË NDRYSHOJË NGA VITI NË VIT, NË BAZË TË NGJASHMËRISË SË VIRUSEVE QË QARKULLOJNË ME ATA QË PËRFSHIHEN NË VAKSINË, DHE NË VARËSI TË MOSHËS DHE TË KUSHTEVE SHËNDETËSORE TË SUBJEKTIT TË VAKSINUAR.

---

## EFEKTET ANËSORE

**Vaksina kundër gripit në përgjithësi tolerohet mirë, vetëm rrallë herë mund të ndodhin efekte anësore me pak rëndësi.** Në vendin e soministrit mund të shfaqen skuqje, ënjtje dhe dhimbje gjatë 48 orëve pas soministrit. Edhe më e rrallë është shfaqja e etheve, dobësia e përgjithshme, dhimbjet e muskujve, të kyçeve dhe dhimbja e kokës pas 6-12 orësh nga soministrit; këto simptoma vërehen më shpesh në ata që vaksinohen për herë të parë dhe nuk zgjasin më shumë se një ose dy ditë. **Reaksionet alergjike ndaj komponentëve të vaksinës janë të jashtëzakonshme.**



**GRIP I MUND TË ÇOJË  
NË KOMPLIKIME SERIOZE,  
VEÇANËRISHT TEK  
TË MOSHUARIT OSE  
ME SËMUNDJE KRONIKE.**

# HPV

**Papiloma virus njerëzor (Human papilloma Virus ose HPV) është infeksioni më i zakonshëm që transmetohet seksualisht:** vlerësohet se mbi 80% e njerëzve seksualisht aktivë infektohen gjatë jetës së tyre.

**Rreziku i kontraktimit të infeksionit fillon me kontaktin e parë seksual dhe mund të zgjasë për tërë jetën.** Për gratë incidenca është më e lartë rreth moshës 25 vjeç ndërsa për burrat mbetet e lartë edhe në moshat e mëvonshme. **Përdorimi i prezervativit zvogëlon rrezikun, por nuk mbron plotësisht nga ky virus** i cili gjithashtu mund të infektojë lëkurën që nuk mbrohet nga prezervativi. Ekzistojnë mbi 100 tipa të HPV që mund të infektojnë racën njerëzore, të cilët ndahen në sierotipa me rrezik të lartë dhe të ulët onkogjen (d.m.th. të aftë për të shkaktuar tumore). Për shembull, tipat 6 dhe 11 (me rrezik të ulët onkogjen) shoqërohen me mbi 90% të kondilomave (lytha gjenital) dhe të papilomatozës së frymëmarrjes që është e rrallë. Ndër tipat që janë në gjendje për të shkaktuar leziona tumorale më të rëndësishmit janë tipat 16 dhe 18, pasi ata janë përgjegjës për më shumë se 70% të kancerit të qafës së mitrës në kazistikat e të gjithë botës. Infeksioni natyror nuk indukton një përgjigje të mjaftueshme të antitropave nga ana e sistemit imunitar prandaj është e mundur të infektohem dhe të shërohemi disa herë gjatë jetës. **Duhet mbajtur mend se HPV janë përgjegjës, megjithëse në një masë më të vogël, edhe për tumoret anogjenitale (vulvë, penis, vagjinë, anus) dhe të orofaringut (buzët, zgavra e gojës dhe faringu) si tek gratë ashtu edhe tek burrat, dhe për këtë arsye është i rëndësishëm vaksinimi edhe për adoleshentët meshkuj.**

Në shumicën e njerëzve, infeksioni HPV është kalimtar (virusi eliminohet nga sistemi imunitar), asimptomatik (ata që janë

infektuar nuk vërejnë asgjë) dhe shërohen spontanisht (zgjidhet brenda 1-2 viteve nga infeksioni); në 10% të rasteve, megjithatë, ai bëhet i vazhdueshëm dhe në këto raste mund të shkaktojë degjenerim qelizor dhe progresion tumoral. **Në veçanti, tek gratë, infeksioni i vazhdueshëm nga HPV onkogjen është kushti i domosdoshëm për evolucionin drejt karcinomës së qafës së mitrës,** por nga ai 10% i grave me infeksion të vazhdueshëm vetëm një pjesë e vogël do të zhvillojë tumorin e qafës së mitrës. Virusi në fakt, megjithatë, nuk është i mjaftueshëm vetvetiu për të zhvilluar tumorin. Pirja e duhanit, përdorimi për një kohë të gjatë i kontraceptivëve oral, bashkë-infeksioni nga HIV ose nga viruset e tjera, numri i madh i partnerëve janë disa nga faktorët që favorizojnë përparimin nga infeksioni në leziona preneoplastike. Tumori i qafës së mitrës është pra një rezultat i rrallë i një infeksioni të zakonshëm.

Evucioni drejt tumorit është një proces shumë i ngadaltë: mund të kalojnë edhe 20 vjet ndërmjet infeksionit dhe shfaqjes së tumorit, kjo ka lejuar **realizimin e programeve të screening që lejojnë diagnostikimin e hershëm të lezionit para-tumoral ose tumoral e si rrjedhim duke bërë ndërhyrjen terapeutike;** është e rëndësishme, edhe pasi të jetë bërë vakcina, të vazhdojmë të kryejmë periodikisht testet e screening. Në fakt, karcinoma e qafës së mitrës është një nga tumoret më të shpeshta në seksin femëror në të gjithë botën, por **në vendet që zbatojnë me korrektësi screening me anë të Pap-testit ose HPV-testit, incidenca e këtij tumori është ulur në mënyrë të dukshme.** Në Itali, screening rekomandohet për gratë ndërmjet 25 dhe 64 vjeç. Në Emilia-Romagna, programi i screening për parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm të tumoreve të qafës së mitrës është një realitet i konsoliduar tash më shumë se 20 vjet dhe është në themel të rënies së vazhdueshme të rasteve të reja dhe të vdekjeve. Ky program azhurnohet dhe monitorohet sipas linjave të udhëzimeve më të përparuara.

**MBI 80% E PERSONAVE SEKSUALISHT AKTIVË INFEKTOHEN ME HPV GJATË JETËS SË TYRE.**

# HPV

## VAKSINA

**PËR SHKAK TË KARAKTERISTIKAVE TË TIJ, VAKSINIMI KUNDËR HPV REKOMANDOHET MË SHUMË NË FILLIM TË PUBERTETIT SESA NË FËMIJËRI.** BËHET FJALË PËR NJË VAKSINË QË PËRMBAN VETËM GRIMCA TË MBËSHTJELLJES VIRALE TË JASHTME, PRANDAJ NUK MUND TË SHKAKTOJË DHE TË TRANSMETOJË SËMUNDJEN.

**STUDIMET KANË NXJERRË NË PAH SE VAKSINA ËSHTË SHUMË E EFEKTSHME NË PARANDALIMIN E INFEKSIONEVE DHE LEZIONEVE PREKANCEROZE DHE KANCEROZE PËR SHKAK TË TIPAVE TË HPV NË PËRMBAJTJE.**

EFIKASITETI I VAKSINËS ËSHTË MAKSIMAL NËSE SOMINISTROHET PARA NJË INFEKSIONI TË MUNDSHËM.

**EFIKASITETI ËSHTË SHUMË I LARTË: 90-100% SI TE FEMRAT ASHTU EDHE TE MESHKUJT** PËRPARA NJË INFEKSIONI TË MUNDSHËM (D.M.TH. KUR ATA NUK KANË KRYER AKOMA MARRËDHËNIE SEKSUALE) DHE, PAVARËSISHT NGA FILLIMI I JETËS SEKSUALE, VAKSINA ËSHTË GJITHSESI MË EFIKASE NË QOFTË SE SOMINISTROHET NË SUBJEKTET MË TË RINJ. NË FAKT, CIKLI I VAKSINIMIT PËRBËHET NGA 2 DOZA ME RRUGË INTRAMUSKULORE TEK FËMIJËT DERI NË MOSHËN 14 VJEÇ DHE 3 DOZA NË FËMIJËT MË TË RRITUR DHE TEK TË RRITURIT. TEK INDIVIDËT ME IMUNITET TË KOMPROMETUAR REKOMANDOHET VAKSINIMI ME 3 DOZA NË ÇDO MOSHË.

**VAKSINIMI PARAQET NJË NDËRHYRJE PARANDALUESE PRIMARE PASI DUKE NDALUAR INFEKSIONIN NGA VIRUSI HPV ELIMINON AGJENTIN SHKAKTAR TË TUMOREVE QË JANË TË LIDHURA ME TË.**

VAKSINA MBRON NGA POTHUAJSE 90% E TUMOREVE TË QAFËS SË MITRËS DHE NGA 80% E LEZIONEVE PARAKANCEROZE, PRANDAJ EDHE NËSE VAKSINOHEN, VAJZAT DO TË DUHET TË VAZHDOJNË TË BËJNË SCREENING, PASI RREZIKU I TUMORIT TË QAFËS SË MITRËS NUK ELIMINOHET PLOTËSISHT.

**NË EMILIA-ROMAGNA E DREJTA PËR NDIHMË MJEKËSORE FALAS GJITHSESI MBAHET DERI NË MOSHËN 18 VJEÇ PËR MESHKUJT, E DERI SA TË MBUSHET MOSHA 26 VJEÇ PËR FEMRAT** DHE OFROHET MUNDËSIA E VAKSINIMIT QË MUND TË KRYHET SIPAS REGJIMIT TË BASHKËNDARJES SË SHPENZIMIT EDHE PËR MOSHAT VIJUESE, SI PËR FEMRAT ASHTU EDHE PËR MESHKUJT.

**NË ITALI VAKSINA OFROHET NË MËNYRË AKTIVE DHE FALAS PËR FËMIJËT NË VITIN E 12 TË JETËS.**

## EFEKTET ANËSORE

**Vaksina anti-HPV ka një profil të lartë efikasiteti dhe sigurie, dhe siguria konfirmohet edhe nga rezultatet e mbikëqyrjes së popullsisë e cila ka disa vite që vaksinohet.** Sidoqoftë, si me të gjitha ilaçet, efektet anësore janë të mundshme: ata më të shpeshtat janë skuqja, dhimbja, ënjtja dhe kruajtja në pikën ku inokulohet vakcina; gjithashtu mund të shfaqen ethe, dhimbje koke, dhimbje të muskujve dhe të kyçeve, simptoma gastrointestinale, kruajtje, erupsion i lëkurës, urtikarie.

Sidoqoftë, këto simptoma janë modeste dhe zgjasin për një kohë të shkurtër.

**TUMORI I QAFËS SË MITRËS ËSHTË KANCERI I PARË QË I ATRIBUOHET PLOTËSISHT NJË INFEKSIONI NGA VIRUSI!**





# Mund të kërkosh informacione

NË NUMRIN JESHIL  
**800 033 033**

Nga e hëna deri të premtën, **nga ora 8.30 deri në orën 18.00**  
Të shtunën, **nga ora 8.30 deri në orën 13.00**

NË FAQET E INTERNETIT

**[salute.regione.emilia-romagna.it](http://salute.regione.emilia-romagna.it)**

Regione Emilia-Romagna (Rajoni Emilia-Romagna)

**[salute.gov.it](http://salute.gov.it)**

Ministero della Salute (Ministria e Shëndetësisë)

**[epicentro.iss.it](http://epicentro.iss.it)**

Istituto Superiore di Sanità (Instituti i Lartë i Shëndetësisë)

**[ecdc.europa.eu](http://ecdc.europa.eu)**

European Centre for Disease Prevention and Control (ECDC)

**[cdc.gov](http://cdc.gov)**

Centers for Disease Control and Prevention (Shtetet e Bashkuara)

**[who.int](http://who.int)**

World Health Organization

## **REDAKTIMI NËN KUJDESIN E:**

Giovanna Mattei, Christian Cintori, Giulio Matteo, Maria Grazia Pascucci

## **KOORDINIMI DHE SUPERVIZIONI REDAKTUES:**

Angela Lucarelli, Caterina Di Monte